



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA Durrës**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 164, datë 03.11.2023



**PËR NJË NDRYSHIM TË VKB NR. 141, DATË 28.09.2023 “PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE PËR PUNONJËSIT E NDËRMARRJEVE DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË BASHKISË Durrës”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; të nenit 112 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe pagës bazë minimale në shkallë vendi”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 150, datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023, si dhe projektbuxhetin afat mesëm 2023-2025”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 141, datë 28.09.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë Durrës”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**VENDOSI:**

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 141, datë 28.09.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë Durrës”, si më poshtë vijon:
  - a. Në lidhjen 6, tabela B: PUNONJËSIT MBËSHTETËS, paga bazë mujore, që i përket numrit rendor 3, bëhet 46 700 lekë.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 06.11.2023**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PREFEKTI I QARKUT Durrës**

Nr. 709 / Prot.  
4

Durrës, më 13 / 11 .2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**  
**DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË**  
**DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.164 datë 03.11.2023 “Për një ndryshim të VKB nr.141 datë 28.09.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e ndërmarrjeve dhe institucioneve në varësi të bashkisë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

